



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
 Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force

Departamenti i Personelit/ Odsek za personal/Department for Personnel

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kreu III, Neni 11 i këtij Ligji, Neni 15 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës shpall këtë:

KONKURS

<u>Titulli i vendit të punës:</u>	<u>Zyrtar i Prokurimit</u>
Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës;	Grada A4
Nr. referencës së vendit të punës;	0394
Vendi;	MFSK

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Të këshillojë sipas udhëzimit Ministrinë e FSK-së dhe FSK-në në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e prokurimit.
- Të zbatojë sipas udhëzimit funksionet e prokurimit dhe kontraktimit në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik në Kosovë dhe rregulloret tjera përkatëse.
- Të zbatojë politikat dhe procedurat e prokurimit duke përfshirë edhe planifikimin e prokurimit sipas udhëzimit.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimit të funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësitë fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.
- Pranimi në shërbimin civil të Kosovës mund të kryhet deri në një (1) vit para moshës së pensionimit.

Proceduarat e konkurrimit

- Shpallja e konkurrimit është e hapur për të gjithë të interesuarit për aplikim.

Shkollimi i kërkuar

- Diploma universitare në ekonomi apo / drejtësi

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen

- Përvojë të kënaqshme në prokurimin publik.
- Njohuri të gjuhës shqipe apo serbe, dhe angleze.
- Përvojë menaxhimi nga ndërmarrja private apo institucioni publik (e dëshiruar).
- Zyrtari duhet të jetë profesional, me përvojë dhe i besueshëm si dhe i aftë që t'i kryej në mënyrë profesionale detyrat e dhëna sipas mandatit dhe ato shtesë brenda periudhës së pranueshme kohore.
- Duhet të ketë aftësi të mira organizative.
- Duhet të përdorë maturinë në detyrë dhe gjatë punës me njerëz.
- Duhet të jetë i motivuar dhe me etikë të lartë pune.
- Ai/ajo duhet të posedojë aftësi që të punojë i/e mëvetësishme si dhe të punojë si ekip me punonjës të tjerë në përmbushjen e detyrave të dhëna.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin

- Procesi i rekrutimit në shërbimin civil të Kosovës është i bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.
- Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e parapara, do t'i nënshtrohen shqyrtimit fillestar të aplikacioneve të tyre.
- Konkurruesit më të suksesshëm do të përfshihen në listën e shkurtër dhe do të ftohen të marrin pjesë në testimin me shkrim dhe me gojë.

- Kandidatët që kalojnë testin me shkrim, do t'i nënshtrohen testit me gojë (intervistimit). Në fund të procesit përzgjedhës kandidatët e pazgjedhur kanë të drejtë ankese.

Kohëzgjatja e emërimit:

- Emërimi është me afat të pacaktuar, ndërsa kohëzgjatja e periudhës provuese është 12 muaj.

Data e mbylljes së konkursit

- Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas datës së shpalljes së parë në të përditshmet kosovare.
- Data e fundit e aplikimit është 13.06.2011.
- Edhe aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, do të konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave

- Formularët duhet të dorëzohen në Departamentin e Personelit personalisht, apo të dërgohen me postë në këtë adresë: **Ministria e FSK-së, Lagja Emshiri 1, 10000 Prishtinë, Departamenti i Personelit/Spektori i Rekrutimit, Kati II, zyra 216 (Ish-ndërtesa e Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së)**, Prishtinë, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.
- Kandidatët duhet t'ia bashkëngjitin aplikacionit kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë për kualifikimet e tij/saj. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kërkesa specifike

- Kjo pozitë i nënshtrohet procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komuniteti joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë përfaqësimi proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, ashtu siç specifikohet në nenin 11. [paragrafin 3 të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës . Kërkesat e pakompletuara dhe të dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Formularët për aplikim janë në dispozicion në Departamentin e Personelit të M-FSK-së, apo në ueb-faqen e M-FSK-së, www.mksf-ks.org , www.ks-gov.net/mfsk, ku gjendet shpallja e konkursit. Për informata plotësuese mund të kontaktoni në: 038 200 13 508.